



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

V E N D I M

Nr. 147, Datë 06/07/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 23, datë 12.02.2018, e Znj. D. F., përfaqësuar nga Qendra “Arsim Cilësor”, ku pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike” dhe “etnisë”, nga ana e Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur, rezulton se ankuesja i përket komunitetit egjiptian të qytetit të Elbasanit dhe familja e saj është në gjendje të vështirë, ekonomike, pasi vetëm babai i saj është i punësuar¹, ndërkohë që nëna e saj është e regjistruar si punëkërkuese e papunë pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Elbasan².

Znj. D. F. ka ndjekur studimet në Fakultetin e Shkencave Humane, Programi i Studimit “Bachelor në Histori Gjeografi”, në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, gjatë viteve

¹ Referuar vërtetimit të lëshuar në datën 23.02.2018, nga SH.P.S.F. “Uevi 2015 Security”;

² Referuar vërtetimit nr. 154, datë 23.02.2018, të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Elbasan;

2014-2017³. Duke qenë se ankuesja i përkiste komunitetit egjiptian, mbështetur në Vendimin Nr. 699, datë 22.10.2014, e Këshillit të Ministrave “Për përjashtimin ose reduktimin nga tarifa vjetore e shkollimit e studentëve që ndjekin programet e studimeve me kohë të plotë të ciklit të parë, programet e studimeve jouniversitare, profesionale, programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe programet e studimeve të ciklit të dytë “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura” në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, **për vitin akademik 2014 – 2015**”, ajo është përjashtuar nga tarifa e shkollimit për ciklin e parë të studimeve.

Aktualisht, Znj. D. F. është studente në ciklin e dytë të studimeve, Master Profesional (MP), Histori, Mësuesi, pranë Universitetit të Tiranës, sistemi me kohë të plotë, për vitin akademik 2017-2018⁴. Ankuesja pretendon se diskriminohet për shkak të “etnisë” dhe “gjendjes ekonomike”, pasi nuk mund të përfitojë 50% zbritje nga tarifa e studimit për studimet master profesional, sikurse është vepruar në vitet akademike të mëparshëm, pasi akti normativ aktual, përkatësisht Vendimi nr. 269, datë 29.03.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, nuk e parashikon një lehtësi të tillë, për studimet e ciklit të dytë, për përfaqësuesit e komunitetit egjiptian.

Znj. D. F. pretendon se është vendosur në pozita diskriminuese për shkak të gjendjes ekonomike dhe etnisë, nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Këshillit të Ministrave. Këto institucione në pozicionin e propozuesit dhe miratuesit të akteve normative, kanë vështirësuar pozitën e saj, për shkak të mos përfitimit të lehtësirave për kryerjen e studimeve, të ciklit të dytë me tarifë të përgjysmuar. Ankuesja thekson faktin, se vetëm përjashtimi nga tarifa e shkollimit për studimet bachelor, nuk ka vlerë, nëse nuk shoqërohet edhe me përgjysmim të tarifës së studimit të ciklit të dytë të studimeve, për studentët që i përkasin komunitetit egjiptian dhe janë në pamundësi ekonomike për t’i vazhduar këto studime me vetëfinancim.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Fillimisht, pas shqyrtimit paraprak të ankesës nr. 23, datë 12.02.2018, së Znj. D. F., u konstatua se për të plotësuar kërkesat formale të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ishte e nevojshme plotësimi i saj me

³ Referuar Vertetimit të Diplomimit, të lëshuar në datën 03.10.2017, nga Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan dhe çertifikatës së notave.

⁴ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u vu në dijeni të këtij fakti gjatë shqyrtimit të ankesës, pasi as ankuesja dhe as përfaqësuesi i saj nuk kanë dhënë informacion për këtë fakt në ankesë.

dokumentacion shtesë. Në vijim të korrespondencës nëpërmjet e-mailit zyrtar me përfaqësuesin e Shoqatës “Arsim Cilësor”, ankesa e Znj. D. F. u plotësua me dokumentacionin e nevojshëm.

2. Referuar akteve të depozituara bashkëlidhur ankesës, u konstatua se ankuesja, nëpërmjet një autorizimi me shkrim, kishte caktuar si përfaqësues të saj, gjatë zhvillimit të procedurave administrative pranë Komisionerit, Z. G. S., Kryetar i Shoqatës “Arsim Cilësor”. Në kushtet kur, pika 2, e nenit 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikon se: *“Organizata me interesa legjitime paraqet prokurë të posaçme për të përfaqësuar personin ose grupin e personave”*, në datën 27.02.2018, ora 11:30, në Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi u realizua një takim i përbashkët ndërmjet përfaqësuesit të Komisionerit, Znj. D. F., Z. G. S. dhe disa përfaqësuesve të tjerë të Shoqatës “Për arsim cilësor”. Në këtë takim të përbashkët, në mungesë të prokurës së posaçme, ankuesja shprehu në mënyrë të drejtpërdrejtë, vullnetin e saj për t’u përfaqësuar nga shoqata e sipërpërmendur.
3. Në vijim, pas analizimit paraprak në tërësi të ankesës nr. 23, datë 12.02.2018, së Znj. D. F., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
4. Nëpërmjet shkresës nr. 241/1 Prot., datë 05.03.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, njoftoi Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë mbi ankesën e mësipërme, si dhe kërkoi informacion mbi çështjen e parashtruar nga ankuesja.
- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dërgoi shkresën nr. 2512/1, datë 20.03.2018, nëpërmjet së cilës e bën me dije Komisionerin se Vendimi nr. 269, datë 29.03.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” ka dalë në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë vendim janë parashikuar kategoritë e studentëve që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit përfshirë edhe kategorinë e studentëve romë dhe ballkano-egjiptianë, të cilët janë pranuar përkatësisht në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve, ose në një program të studimeve profesionale.

Neni 4, i ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” përcakton se shteti garanton arsimimin për individët që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, por që nuk kanë mundësitë financiare për t’i përballuar ato. Në këto programe studimi, u garantohet arsimimi edhe individëve, të cilëve u njihet kjo e drejtë me ligje të veçanta.

Sipas shkresës së sipërpërmendur, Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, në nenin 3 të tij, përcakton se Institucionet publike të Arsimit të Lartë, kanë të drejtë për të caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit. Gjithashtu, në po të njëjtin nen të ligjit të sipërcituar, është përcaktuar e drejta e autonomisë financiare të institucioneve të arsimit të lartë, e cila garantohet, krahas të tjerash, edhe nëpërmjet të drejtës për të përcaktuar tarifat e studimit. Tarifat e studimit përcaktohen përmes akteve të brendshme që rregullojnë veprimtarinë e organeve kolegjiale në IAL-të publike.

Për sa më sipër, lidhur me ankesën e Znj. D. F., Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë shprehet se trajtimi i saj është në kompetencë të institucionit përkatës arsimor, pasi ligji njeh të drejtën e institucioneve publike të arsimit të lartë dhe organeve kolegjiale të saj për të marrë vendime, lidhur me tarifat e studimit në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve.

5. Në kushtet kur në formularin e ankesës, ankuesja deklaronte se kishte aplikuar për të ndjekur studimet për master profesional, pa përcaktuar Universitetin pranë së cilit kishte aplikuar, si dhe në kushtet kur përgjatë një bisede telefonike ajo kishte përmendur se kishte aplikuar pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, në vijim të shqyrtimit të ankesës nr. 23, datë 12.02.2018, Komisioneri për Mbrotjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 241/3, datë 05.04.2018, Z. A. R., Dekan i Fakultetit të Shkencave Humane, pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, nëpërmjet së cilës i kërkohej informacion mbi çështjen e parashtruar nga ankuesja. Shkresa e sipërpërmendur iu dërgua për dijeni edhe përfaqësuesit të ankueses.

- Në vijim të shkresës së sipërpërmendur, Shoqata “Për arsim cilësor”, nëpërmjet e-mailit të datës 11.04.2018, e bën me dije Komisionerin se ankuesja nuk kishte aplikuar për të ndjekur masterin profesional pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, por ajo aktualisht ndiqte vitin e parë, për master profesional pranë Fakultetit të Historisë dhe Filozofisë, pranë Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2017-2018, fakt, i cili nuk i ishte bërë i ditur

Komisionerit, deri në momentin e dërgimit të e-mailit. Bashkëlidhur e-mailit u dërgua dhe vërtetimi përkatës i lëshuar nga Universiteti i Tiranës.

- Z. A. R., Dekan i Fakultetit të Shkencave Humane, pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan nuk dërgoi përgjigje në adresë të Komisionerit.
- 6. Në kushtet kur, Komisioneri u vu në dijeni të fakteve të reja nga ana e subjektit ankues, 2 muaj pas fillimit të procedurave hetimore për shqyrtimin e çështjes, në vijim iu drejtua me shkresën nr. 241/5, datë 19.04.2018, Z. S. L., Dekan i Fakultetit të Historisë dhe Filozofisë, pranë Universitetit të Tiranës, ku mbështetur në shkresën nr. 2512/1, datë 20.03.2018, e Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, iu kërkua informacion mbi çështjet e mëposhtëme:
 - ⇒ Rastet, në të cilat, Fakulteti i Historisë dhe Filozofisë, pranë Universitetit të Tiranës, ka përcaktuar, nëpërmjet akteve të tij, të brendshme, tarifa të reduktuara për studimet e ciklit të dytë;
 - ⇒ Kriteret, që kërkohen të plotësohen nga kandidatët, që paraqesin kërkesë për reduktim të tarifës së studimit, për të vazhduar ciklin e dytë të tyre (master profesional ose shkencor);
 - ⇒ Procedura që duhet të ndjekë Znj. D. F., për të përfituar reduktim të tarifës së studimit për Master Profesional pranë Fakultetit të Historisë dhe Filozofisë (UT).
- Në përgjigje të shkresës nr. 241/5, datë 19.04.2018, të Komisionerit, Dekani i Fakultetit të Historisë dhe Filozofisë dërgoi shkresën nr. 467/1, datë 23.04.2018, ku informon se për vitin akademik 2017-2018 nuk ka patur asnjë përjashtim nga tarifa e shkollimit për studentët e ciklit të dytë të studimeve, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. Në këtë kontekst, theksohet fakti se nuk ka patur asnjë diskriminim për shkak etnie apo gjendjeje ekonomike as për studenten D. F. dhe as për ndonjë student tjetër, sepse nuk është urdhëruar procedura e përjashtimit të studentëve të kategorive sociale, që përjashtohen nga tarifat e shkollimit, për asnjë student të ciklit të dytë të Universitetit të Tiranës.

Në shkresën nr. 101, datë 11.01.2018 “Mbi miratimin e studentëve të kategorive të veçanta”, të Administratorit të UT është sqaruar fakti, se meqënëse Vendimi nr. 269, datë 29.03.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” ka tagër veprimi vetëm për studentët e ciklit të parë, për studentët e ciklit të dytë, kjo procedurë do të kalonte për miratim në organet kolegjiale. Në shkresë theksohej fakti se në bazë të Ligjit nr.

80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, këtë kompetencë e ka Bordi i Administrimit të UT.

Në vijim, Komisioneri informohet se nëpërmjet shkresës nr.219, datë 21.03.2018, Kryetarja e Bordit të Administrimit të UT ka kërkuar efektin financiar që rrjedh nga përjashtimi i studentëve të ciklit të dytë, pranë Fakultetit të Historisë dhe Filozofisë. Strukturat përkatëse kanë mbledhur dokumentacionin e studentëve që pretendojnë se përfshihen në kategoritë sociale përjashtimore. Ky dokumentacion i është paraqitur për shqyrtim dhe aprovim Bordit të Administrimit të UT-së, me qëllim marrjen e një vendimi nga ana e tij.

Për sa më sipër, Dekani i Fakultetit të Historisë dhe Filozofisë, së UT, e bën me dije Komisionerin se studentja D. F. ka depozituar dosjen personale dhe emri i saj bën pjesë në listën emërore të studentëve të ciklit të dytë, e cila është nisur drejt Bordit të Administrimit të UT, me qëllim miratimin e tarifave të reduktuara të shkollimit. Ndërkohë që, Fakulteti i Historisë dhe Filozofisë është në pritje të marrjes së vendimit nga ana e Bordit të Administrimit të UT, për të vepruar në lidhje me ata studentë të ciklit të dytë që i plotësojnë kriteret dhe dokumentacionin ligjor për t’u përjashtuar 50% nga tarifa e shkollimit.

7. Në vijim të procedurave hetimore, Komisioneri iu drejtua Kryetares së Bordit të Administrimit të UT, me shkresën nr. 607, datë 04.05.2018, ku kërkohet informacion lidhur me çështjet e mëposhtëme:

⇒ Akte të brendshme, administrative, të miratuara nga Bordi i Administrimit të UT, nëpërmjet së cilave, të jenë përcaktuar saktësisht:

- Kriteret, që duhen plotësuar nga studentët e ciklit të dytë, të cilët mund të përfitojnë tarifa të reduktuara të shkollimit;
- Procedurat që duhet të ndiqen nga Fakultetet e në vijim nga Bordi i Administrimit të UT, për përzgjedhjen e këtyre studentëve;
- Periudha kohore, përgjatë së cilës, duhet të kryhet dorëzimi i dokumentacionit të studentëve pranë Fakulteteve respektive dhe Bordit të Administrimit të UT;
- Afati kohor, brenda së cilit, Bordi i Administrimit të UT duhet të dalë me vendim për të përcaktuar studentët që përfitojnë reduktim të tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve.
- Mbështetur në praktikën e vitit të mëparshëm akademik kërkohet informacion, lidhur me numrin e studentëve të ciklit të dytë, që kanë përfituar tarifë të reduktuar të shkollimit të tyre, si dhe të përcaktohen kategoritë e veçanta, të cilëve ata u përkasin.

- Nëse Bordi i Administrimit të UT e ka përfunduar procesin e përzgjedhjes së studentëve që do të përfitojnë 50% të tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve për Fakultetin e Historisë dhe Filozofisë, për vitin akademik 2017-2018, të dërgohet informacion pranë Komisionerit, nëse Znj. D. F. është përzgjedhur si një ndër përfitueset. Në këtë kontekst, të cilësohet kriteri, që është marrë parasysh për përzgjedhjen e saj.
- Në kushtet kur, Bordi i Administrimit të UT nuk dërgoi përgjigje brenda afatit të përcaktuar në shkresën e Komisionerit, ky i fundit iu drejtua sërisht me shkresën nr. 664, datë 15.05.2018, ku i bën kujtesë për dërgimin e informacionit të kërkuar.
- Me shkresën nr. 275, datë 29.05.2018, Bordi i Administrimit të Universitetit të Tiranës e informon Komisionerin, se për vitet akademike 2016-2017 dhe 2017-2018 nuk ka marrë asnjë vendim mbi përgjysmimin e tarifës së shkollimit për studentët e regjistruar në programet e studimit të ciklit të dytë në Universitetin e Tiranës. Aktualisht, Bordi i Administrimit, nëpërmjet shkresës nr. 219, datë 21.03.2018, u ka kërkuar të gjithë njësitë kryesore të paraqesin propozime mbi kategoritë, që ata vlerësojnë se duhet të përfitojnë për përgjysmim të tarifës së shkollimit në programet e studimit të ciklit të dytë (Master Profesional dhe Master i Shkencave).

Me Vendimin nr. 14, datë 17.05.2018, të Senatit Akademik, “Mbi përcaktimin e kategorive të studentëve, që plotësojnë kriteret për reduktimin në masën 50% të tarifës së shkollimit në programet e ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë për vitin akademik 2017-2018” Senati Akademik i ka propozuar Bordit të Administrimit, miratimin e kategorive sociale për përjashtim nga tarifa e shkollimit në masën 50%. Në këto kategori bëjnë pjesë edhe studentët që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian.

Komisioneri u bë me dije se Bordi i Administrimit, në mbledhjen e rradhës do të trajtojë këtë propozim dhe do të vendosë edhe mbi dokumentacionin e nevojshëm, afatet e dorëzimit dhe vendin, ku do të paraqiten dokumentat. Me përcaktimet e Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, duke filluar nga viti akademik 2016-2017, janë vetë institucionet e arsimit të lartë ato që përcaktojnë kuotat, tarifatat dhe kategoritë që do të përjashtohen nga tarifa e shkollimit në ciklin e dytë të studimeve. Bordi i Administrimit do të komunikojë pranë të gjitha njësitë kryesore për vendimin që do të merret për kategoritë e vecanta sociale që do të përfitojnë përgjysmim të tarifës së shkollimit në programet e ciklit të dytë të studimeve për vitin akademik 2017-2018. Ky vendim do të përcillet edhe pranë Komisionerit.

⇒ Në vijim, nëpërmjet e-mailit të dërguar, në datën 02.07.2018, nga ana e strukturave përgjegjëse të Rektoratit të Tiranës, Komisioneri u informua mbi Vendimin nr. 45, datë 25.06.2018, të Bordit të Administrimit të UT “Mbi përcaktimin e kategorive të studentëve që plotësojnë kriteret për reduktimin në masën 50% të tarifës së shkollimit në programet e ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë për vitin akademik 2017-2018”.

Në këtë vendim janë përcaktuar kategoritë e studentëve, që përfitojnë reduktim të tarifës së shkollimit në masën 50%. Në referencë të pikës 1, gërma g), të këtij vendimi, kategoria Ballkano-egjiptiane rezulton përfituese nga tarifat e mësipërme.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

I. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të pretenduar nga ankuesja:

Znj. D. F. ka ndjekur studimet në Fakultetin e Shkencave Humane, Programi i Studimit “Bachelor në Histori Gjeografi”, në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, gjatë viteve 2014-2017. Meqënëse, ankuesja i përket komunitetit egjiptian, ajo është përjashtuar nga tarifa e shkollimit për ciklin e parë të studimeve, në bazë të parashikimeve të Vendimit Nr. 699, datë 22.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përjashtimin ose reduktimin nga tarifa vjetore e shkollimit e studentëve që ndjekin programet e studimeve me kohë të plotë të ciklit të parë, programet e studimeve jouniversitare, profesionale, programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe programet e studimeve të ciklit të dytë “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura” në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2014 – 2015”.

Znj. D. F. pretendon se diskriminohet për shkak të “etnisë” dhe “gjendjes ekonomike”, nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pasi aktualisht nuk mund të përfitojë 50% zbritje nga tarifa e studimit për studimet master profesional, pasi akti normativ aktual, përkatësisht Vendimi nr. 269, datë 29.03.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, nuk e parashikon një lehtësi të tillë, për studimet e ciklit të dytë, për përfaqësuesit e komunitetit egjiptian.

Për sa më sipër, Vendimi nr. 269, datë 29.03.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve

profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” ka dalë në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Neni 4, i ligjit të sipërpërmendur parashikon shprehimisht se shteti garanton arsimimin për individët që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, por që nuk kanë mundësitë financiare për t’i përballuar ato. Në këto programe studimi, u garantohet arsimimi edhe individëve, të cilëve u njihet kjo e drejtë me ligje të veçanta.

Në këtë vendim janë parashikuar kategoritë e studentëve që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit përfshirë edhe kategorinë e studentëve romë dhe ballkano-egjiptianë, të cilët janë pranuar përkatësisht në:

- ⇒ Një program të ciklit të parë të studimeve;
- ⇒ Në një program të integruar të studimeve, ose
- ⇒ Në një program të studimeve profesionale.

Për sa më sipër, vihet re se kategoritë e mësipërme nuk përfitojnë tarifa lehtësuese për ndjekjen e studimeve master profesional apo shkencor.

Pavarësisht se aktualisht nuk është miratuar ndonjë akt normativ që siguron tarifa lehtësuese për ndjekjen e studimeve master profesional apo shkencor për kategoritë vunerabël, ndër të cilat edhe për kategorinë e ballkano-egjiptianëve, kjo nuk do të thotë se ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” nuk i ka dhënë zgjidhje një çështjeje të tillë. Referuar parashikimit të nenit 2, gërma dh), qëllimi i këtij ligji është të garantojë mundësi të barabarta, mbi bazën e meritës, për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë. Në këtë kontekst vlen të theksohet fakti se një ndër misionet e arsimit të lartë, të parashikuara në nenin 1, gërma c), të ligjit të sipërpërmendur është të ofrojë mundësi të barabarta për të fituar nga ky arsim dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës.

Rregullimi aktual, që ligji i sipërpërmendur i bën situatës konkrete, mbështetet në parashikimin e nenit 3⁵ të tij, i cili u siguron në mënyrë të shprehur institucioneve të arsimit të lartë, liri

⁵ Neni 3 “Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë”, e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” parashikon: “1. *Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.* 2. *Liria akademike garantohet nëpërmjet së drejtës: a) për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato kërkimore-shkencore, të inovacionit, si dhe veprimtaritë krijuese; b) për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore; c) për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik.* 3. *Autonomia financiare garantohet nëpërmjet së drejtës: a) për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, nga veprimtaritë artistike e sportive, si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi; b) për të përfituar fonde nga*

akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3, pika 3, i Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, parashikon shprehimisht:

“3. Autonomia financiare garantohet nëpërmjet së drejtës:

a) për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, nga veprimtaritë artistike e sportive, si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) për të përfutuar fonde nga shteti dhe organizma të tjerë;

c) për të caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit;

ç) për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me këtë ligj;

d) për të administruar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që institucionet zotërojnë ligjërisht, në përputhje me misionin e tyre”.

Në këtë kontekst, vihet re se nëpërmjet dispozitës së sipërcituar, ligji përcakton se institucionet publike të arsimit të lartë, kanë të drejtë për të caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit. Në këtë dispozitë është përcaktuar e drejta e autonomisë financiare të institucioneve të arsimit të lartë, e cila garantohet, krahas të tjerash, edhe nëpërmjet të drejtës për të përcaktuar tarifat e studimit. Tarifat e studimit përcaktohen përmes akteve të brendshme që rregullojnë veprimtarinë e organeve kolegjiale në IAL-të publike.

shteti dhe organizma të tjerë; c) për të caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit; ç) për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me këtë ligj; d) për të administruar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që institucionet zotërojnë ligjërisht, në përputhje me misionin e tyre. 4. Autonomia organizative dhe e përzgjedhjes së personelit garantohet nëpërmjet së drejtës: a) për t’u vetëqeverisur, për të zgjedhur organizmat drejtues, për të organizuar strukturat dhe rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të tyre të brendshme, të hartuara në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi; b) për të caktuar kritere për pranimin e studentëve në programet e studimit, në përputhje me këtë ligj; c) për të lidhur marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse, kërkimoreshkencore, kualifikuese, inovative, si edhe veprimtari të tjera të ligjshme; ç) për të caktuar në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, si dhe për të përcaktuar pagat e personelit, në përputhje me formën e institucionit.”

Për sa më sipër, sikurse rezultoi përgjatë hetimit administrativ të ankesës së Znj.D. F., Bordi i Administrimit të UT, në cilësinë e organit më të lartë kolegjal administrativ, që garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij, në bazë të kompetencave që i njihen shprehimisht nga neni 49, i ligjit të sipërpërmendur, në bashkëpunim me Senatin Akademik⁶ dhe Fakultetet e Universitetit të Tiranës ka miratuar Vendimin nr. 45, datë 25.06.2018, nëpërmjet së cilit ka përcaktuar kategoritë e studentëve, që ndjekin studimet në programet e ciklit të dytë të studimeve në vitin akademik 2017-2018, të cilët përfitojnë reduktim të tarifës së shkollimit në masën 50%.

Referuar pikës 1, të Vendimit nr. 45, datë 25.06.2018, të Bordit të Administrimit të UT-së, kategoritë përfituese parashikohen si më poshtë:

“1. Studentët që ndjekin studimet në programet e ciklit të dytë të studimeve në vitin akademik 2017-2018 (viti i I-rë dhe viti II-të), të cilët i përkasin kategorive të mëposhtëme, përfitojnë reduktim të tarifës së shkollimit në masën 50%:

- a. Personat që nuk shikojnë/dëgjojnë;*
- b. Invalidët e punës dhe fëmijët e tyre;*
- c. Invalidët;*
- d. Invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre;*
- e. Jetimët;*
- f. Romët;*
- g. Ballkano- egjiptiane;*
- h. Personi, njëri nga prindërit e të cilit është ndarë nga jeta dhe familja, në këtë rast përfiton ndihmë ekonomike nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore;*
- i. Ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë nga sistemi komunist ose fëmijët me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;*
- j. Fëmijët e policëve dhe ushtarakëve të F.A. që kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës.”*

Sikurse vihet re, referuar pikës 1, gërma g), të vendimit të sipërpërmendur, kategoria e studentëve ballkano-egjiptianë është përcaktuar si një ndër kategoritë përfituese.

Në pikën 2 të tij, përcaktohet se ky vendim i shtrin efektet e tij financiare dhe për studentët që kanë filluar studimet në programet e ciklit të dytë të studimeve në vitin akademik 2016-2017. Në këtë mënyrë, trajtohen dhe ndihmohen financiarisht të gjithë studentët e kategorive të

⁶ Në bazë të Vendimit nr. 14, datë 17.05.2018, të Senatis Akademik “Mbi përcaktimin e kategorive të studentëve, që plotësojnë kriteret për reduktimin në masën 50% të tarifës së shkollimit në programet e ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë për vitin akademik 2017-2018” janë propozuar kategoritë vunerabel, që duhet të jenë përfitues.

mësipërme, që prej momentit të hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Pavarësisht sa më sipër, Komisioneri sjell në vëmendje faktin, se akte të tilla, sikurse Vendimi nr. 45, datë 26.06.2018, i Bordit të Administrimit të UT-së, duhen miratuar në fillim të vitit akademik pasardhës, duke bërë parashikimet përkatëse në buxhet në momentin e duhur. Vonesa në marrjen e vendimeve të tilla mund të ndikojë negativisht dhe të paragjykojë të drejtën e studimit të individëve, që janë të pamundur financiarisht të kryejnë pagesën e tarifës së shkollimit. Në këtë kontekst, Komisioneri thekson faktin se vonesa të tilla në vendimmarrje nga institucionet kompetente nuk ndikojnë pozitivisht në procesin e edukimit dhe shkollimit të shtresave dhe kategorive vunerabël. Komisioneri gjykon se Universiteti i Tiranës, në cilësinë e institucionit akademik ka detyrim të nxisë dhe promovojë efektivisht arsimin e lartë, sidomos për kategoritë në nevojë dhe komunitetet, që janë më pak të avantazhuara.

Në referencë të pikës 1, të nenit 7, si dhe nenit 17, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk i është nënshtruar një trajtimi apo qëndrimi të padrejtë, të pabarabartë dhe disfavorizues, nga ana e Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit. Në mungesë të një trajtimi të tillë, përjashtohet mundësia e diskriminimit të ankueses për shkak të “etnisë” dhe “gjendjes ekonomike”, nga institucionet e sipërpërmendura.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 17, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenin 1, gërma c), nenin 2, gërma dh), neni 3, të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin nr. 45, datë 25.06.2018, e Bordit të Administrimit të UT-së “Mbi përcaktimin e kategorive të studentëve që plotësojnë kriteret për reduktimin në masën 50% të tarifës së shkollimit në programet e ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë për vitin akademik 2017-2018”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

- 1.** Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “etnisë” dhe “gjendjes ekonomike”, të Znj. D. F., nga ana e Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit.
- 2.** Marrjen e masave të nevojshme nga Bordi i Administrimit të UT, si dhe institucionet e tjera arsimore që bashkëpunojnë me të, që në vitet akademikë pasardhës, situata të tilla të mos përsëriten më.
- 3.** Kundër këtij vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

(Shkak: etnia dhe gjendja ekonomike,
Fusha: Arsim)